



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 51, DATË 31.07.2024

“PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË EMERGJENCËS CIVILE”

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 31.07.2024 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencës civile”. Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, VKM nr 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” i dryshuar, pika 3, shkronja g, Udhëzimin nr 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, VKB nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024”, shkresës nr 2661, datë 04.04.2024 nga Ministria e Financave.

V E N D O S I:

1. Të miratoj përdorimin e fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile në shumën 848,400 lekë për blerjen e materialeve logjistike “pompa luftuese me ujë dhe motogjenerator ajri ” me qëllim marrjen e masave parandaluese.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit

Etleva Yzo

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

